



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova



Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Procesverbali nga diskutimi publik për Propozim Rregulloren për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive “Hakif Zejnullahu”

Të mërkurën më 18.05.2022 u mbajt diskutim publik në sallën e mbledhjeve të kuvendit komunal.

Diskutimin e hapi drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Pajtim Balaj, i cili prezantoi dispozitat e përgjithshme të rregullores, e cila përcakton mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive, aktivitetet sportive të klubeve të regjistruara në Federatat gjegjëse, manifestmeve të ndryshme të kulturës, tubimeve, partiake, revistave, rekreacionit si dhe grupeve të tjera jo formale.

Drejtori Balaj foli edhe për klubet të cilat kanë drejtë në shfrytëzimin e palestrës, procedurat e kërkesës për shfrytëzim, rregullat themelore për shfrytëzimin e objekteve sportive (rendi shtëpiak), vendosjen e reklameve, dokumentacionin e nevojshëm për shfrytëzimin e palëstrës, pagesat si dhe masat ndërkuese për ata që nuk i përmbahen rregullores në fjalë.

Pas prezantimit të rregullores drejtori Balaj hapi diskutimin.

Lavdim Zeneli- anëtar i klubit të vulejbollit, e paraqiti një ankesë te drejtori Balaj sa i përket ndërrimit të orarit për klubin të cilin e përfaqëson, ai theksoi se prej dy termineve që kishin në të kaluarën për ushtrime, tani ata kanë vetëm një termin, i cili i pamundëson ushtrimet e klubit të vulejbollit, dëshiron të bëhet një zgjedhje në mënyrë që të kenë hapësirë për ushtrime.

Drejtori Balaj tha se do të merret me çështjen në fjalë dhe do të angazhohet të ju ofrojë të gjithëve kushte dhe mundësi të barabarta.

Podujevë

30.05.2022



Kuvendi i Komunës së Podujevës



Kuvendi i Komunës së Podujevës

A decorative graphic element consisting of a grid of small squares in blue and white, positioned below the text and above the speaker.